



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 134, Datë 04 / 12 / 2017

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 87, datë 03.08.2017, e bërë nga E.P¹, kundër OSHEE Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Racës”.

Institucioni i Komisionerit gjatë takimeve të zhvilluara në qytetin e Beratit, në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura”, ka administruar disa ankesa lidhur me sjelljen dhe trajtimin e personave të komunitetit Rom dhe Egjiptian nga ana e subjekteve publike dhe private në qytetin e Beratit. Një nga këto ankesa është në emër të shtetases E.P.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: *“Fatura e energjisë është me mbiemrin K..... dhe ankuesja kërkon që të jetë me mbiemrin P....., pasi mund të përfitojë zbritje çmimi si pensioniste që është. Është paraqitur disa herë pranë zyrave të OSHEE por nuk ka gjetur zgjidhje”*. Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të bëhet e mundur ndryshimi i mbiemrit nga K.... në P.....

Raca, është shkak për të cilin ligji nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën.

¹ Ankuesja i përket komunitetit rom të qytetit të Beratit.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën Nr. 790/1 prot, datë 28.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e OSHEE Berat, lidhur me ankesën e bërë nga E. P, për ndryshimin e mbiemrit në kontratën e furnizimit me energji elektrike.

Me shkresën nr. 2012/1, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të administruar tek Komisioneri me nr. 790/2 prot, datë 11.10.2017, OSHEE Berat, informon se: “Nga verifikimi në sistemin e faturimit rezulton se me emrin E.K ekziston vetëm një kontratë BE1A1200....., në adresën, lagjja: Donika Kastrioti, ndërsa në adresën: Stan, Moravë nuk rezulton asnjë abonent me emrin E.K. Nga punonjësit e OSHEE, pas vënies në dispozicion të një numër kontakti nga zyra e Komisionerit, është tentuar të komunikohet në telefon me E.P, në numrin 069..... por ky numër rezulton i fikur”.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr.133, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit në Drejtorinë Rajonale të OSHEE Berat”, inspektorët e KMD-së me datë 11.10.2017 u paraqitën pranë OSHEE Berat, me qëllim marrjen e informacionit dhe kryerjen e verifikimeve përkatëse, lidhur me ankesën e E.P.

Gjatë inspektimit, G.K me detyrë, Shef i Degës së Shitjes dhe Arkëtimeve pranë OSHEE Berat, informoi se: “Sipas procedurave të OSHEE, Klienti duhet të paraqitet tek zyra e marrëdhënieve me klientin së bashku me faturën e energjisë elektrike dhe të bëjë kërkesë dhe pastaj të marrë përgjigje. Në zyrat e OSHEE nuk figuron asnjë kërkesë nga E.P. Nëse E.P i plotëson kriteret e ndryshimit të mbiemrit padyshim që do plotësohet kërkesa”.

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vëren se procedurat e OSHEE në lidhje me veprimet që duhet të kryejnë klientët e OSHEE janë të publikuara në faqen web në adresën: www.oshee.al, “Shërbimet që ofrohen në qendrat e Kujdesit ndaj Klientit si dhe dokumentacionin

e caktuar që nevojitet për kërkesat apo ankesat e klientit”. Në këto procedura është përcaktuar që klienti duhet të plotësojë një formular sipas kërkesës që ka të shoqëruar me disa dokumente verifikuese, që janë: Mjet identifikimi, kopje e faturës së energjisë, kopje dokumentit të pronësisë etj, pra kërkohet detyrimisht që të hartohet një kërkesë e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar ndryshimin e të dhënave të kontratës së furnizimit me energji elektrike.

Bazuar në përgjigjen e OSHEE, inspektorët e KMD-s, provuan disa herë për të kontaktuar me E.P në numrin: 069..... të vënë në dispozicion nga ankuesja në formularin e ankesës, por pa sukses, pasi numri ishte jashtë shërbimi.

Bazuar në përgjigjen shkresore të dërguar nga OSHEE Berat², nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e OSHEE Berat, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk ka bërë kërkesë për ndryshimin e mbiemrit në kontratën e furnizimit me energji elektrike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a dhe c/, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të racës, ndaj E.P, nga ana e OSHEE Berat.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, se nëse kërkon të bëjë ndryshime në kontratën e furnizimit me energji elektrike, të paraqitet pranë Qendrës së Kujdesit ndaj Klientit, të OSHEE Berat, për të plotësuar fillimisht kërkesën, dhe më pas për të depozituar dokumentacionin e kërkuar nga OSHEE.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

² Nr. 2012/1, datë 07.10.2017